



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 18.12.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e funksionimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:55 dhe mbaroi në orën 14:39

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Erion Fejzulla, USAID.*
- 8. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e funksionimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”.

Naureda Llagami: Atëherë, përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mbledhjen e datës 18 dhjetor 2019. Të gjithë anëtarët janë të pranishëm.

Në radhë të parë falënderoj prezencën e mediave që është edhe sot e pranishme. Dëshiroj vëmendje se sot kemi një lajm të mirë, i cili në fakt përkon afërsisht edhe me 1 vjetorin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky është në fakt urimi më i mirë që sot ne mund të marrim në këtë përvjetor të parë, i cili kulmon me punën tonë të përbashkët për një vendimmarrje të rëndësishme, që është fillimi i punës së Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ky fillim është një hap përpara në luftën e përbashkët kundër pandëshkueshmërisë. Është një hap përpara drejt përmbushjes së atyre pritshmërive që çdo qytetar ka ndaj nesh si Këshill por edhe ndaj reformës në

drejtësi. Prandaj, një falënderim i jashtëzakonshëm i shkon sot partnerëve ndërkombëtarë për mbështetjen e këtij procesi dhe gjithë punës së Këshillit, gjatë këtij viti të parë dhe vendimtar në punën tonë, të gjithë kolegëve për përkushtimin dhe debatet e përgjegjshme dhe profesionale, për median dhe publikun, që na ka mbështetur me durim dhe besim në çdo hap.

Me vendimmarrjen e sotme, Këshilli plotëson arkitekturën institucionale dhe mekanizmin kushtetues që e bën luftën e përbashkët kundër korrupsionit, edhe në nivelet më të larta të shtetit, një përpjekje reale dhe të mundshme.

Sot kemi parashikuar në mbledhjen e ditës vetëm një çështje të rëndësishme, që është bërja funksionale e Gjykatës së Posaçme.

Me konkretisht, çështjet që ne do të diskutojmë sot është “Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e funksionimit të gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar””.

Është “Shqyrtimi i projektvendimeve për caktimin e përhershëm të pesë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar”.

Shqyrtimin e projektvendimeve për caktimin e përkohshëm të trembëdhjetë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Dhe çështja e fundit që është shqyrtimi i projektvendimeve për transferimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda pranë gjykatave në juridiksionin e përgjithshëm.

Përpara se të kalojmë në relatimin e projekt-akteve, që siç jeni në dijeni lidhen të gjithë me bërjen funksionale të Gjykatës së Posaçme, unë i ftoj të gjithë gazetarët të ulen pranë ambientit të sallës tonë plenare dhe kamerat të vazhdojnë për të na lejuar diskutimin e çështjeve që kemi.

(Kameramanët dalin nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, lidhur me relatimin e projekt-aktit të parë, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, sipas pikës së parë të rendit të ditës është projektvendimi “Për fillimin e funksionimit të gjykatave të posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Sa i përket rëndësisë së vendimit, e parashtrori Kryetarja e Këshillit. Unë do të ndalem në aspekte teknike të këtij projektvendimi.

Ky projektvendim, sikundër dhe relacioni që ju keni përpara, konsideron apo merr në konsideratë nenet 135, pikat 1 dhe 2, nenin 147, pikën 1, nenin 147, shkronja “ë” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 162 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 3, shkronja “b”, nenin 11, nenin 15, pika 4, shkronjat “c” dhe “ç”, nenin 22 dhe nenin 83, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 57 të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Nuk po ndalem të referoj rregullimet specifike në këto dispozitat ligjore por referuar të cilave Këshilli ka obligimin që të konsiderojë fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe të adoptojë disa masa që ato të jenë efikase që ditën që do të fillojë funksionimi i tyre.

Konkretisht, në pikën 1 të projektvendimit, në kreun I të projektvendimit, ku janë rregullime të përgjithshme, bëhet fjalë për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019. Ndërkohë që në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, sikundër përcakton edhe Kushtetuta, parashikohet që Gjykata e Shkalla e Parë për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sa i përket datës së fillimit të funksionimit të Gjykatave të Posaçme është mbajtur në konsideratë fakti se Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ndërsa ka pasur një proces specifik sa i përket krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, tashmë ka emëruar Prokurorin e kësaj prokurorie, ndërsa vendimet e emërimit i fillojnë efektet më datë 19 dhjetor 2019. Po kështu është mbajtur në

konsideratë se sipas njoftimit publik të institucionit të Presidentit të Republikës, më datën 19 dhjetor të vitit 2019 prokurorët e emëruar pranë Prokurorisë së Posaçme do të bëjnë betimin para Presidentit të Republikës dhe në këtë mënyrë ata fillojnë ushtrimin e detyrës menjëherë.

Mbi këtë bazë është propozuar që data e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të jetë data 19 dhjetor i vitit 2019.

Ka një propozim sa i përket emërimit të Gjykatave të Posaçme, referuar disa ligjeve që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Formulimi i emërimit të tyre nuk është tërësisht i njëjtë. Në disa referohet si emërtim Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndërsa në disa ligje emërtohet që janë Gjykata të Posaçme për Gjykimin e Veprave Penale të Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Për arsye edhe praktike, por duke gjetur tërësisht formulimin më korrekt, kemi propozuar që emërtimi i Gjykatës së Posaçme të jetë Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në varësi të shkallëve, të shkallës së parë apo apelit.

Kemi mbajtur në konsideratë edhe praktikitetin e përdorimit të emërimit të këtyre gjykatave por edhe sugjerime që janë bërë nga gjyqtarët e gjykatave për krimet e rënda.

Në kreun II të projektvendimit janë parashikuar disa përcaktime në lidhje me Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, konkretisht sa i përket selisë së kësaj gjykate, seli kjo që e ka përcaktuar edhe legjislacioni në fuqi, që do të jetë në Tiranë, ndërsa ushtrojnë veprimtarinë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe selia do të vendoset në ndërtesat aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, apo të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Po kështu është përcaktuar edhe numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është përcaktuar të jetë 16 (gjashtëmbëdhjetë), që është edhe numri minimal ligjor që përcakton ligji për këtë gjykatë. Ky numër është vendosur fillimisht në kufirin minimal meqenëse jemi në momentin e fillimit të funksionimit të kësaj gjykate, ndërkohë që në varësi të punës që do të kenë këto gjykata në vijimësi, Këshilli do duhet të rivlerësojë numrin e tyre, referuar objektivave ligjorë që ia përcakton ligji.

Në kreun II është përcaktuar edhe vijimi i ushtrimit të funksioneve administrative, kjo sa i përket kryetarit dhe kancelarit në detyrë. Sikundër ligji ka përcaktuar për të gjithë stafin e gjykatave të cilët transferohen automatikisht në Gjykatat e Posaçme, pra stafi për gjykatat e krimeve të rënda, edhe organet drejtuese ligji përcakton që të vijojnë të qëndrojnë në detyrë, kryetari, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të kësaj gjykate, pra të Gjykatës së Posaçme, për përjashtim të rastit kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa kancelari në detyrë që në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda është zoti {...}, do të qëndrojë në detyrën e kancelarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor ose si rezultat i procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Sa i përket kryetarit në detyrë të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda që do të vijojë të qëndrojë në detyrë edhe sa i përket Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ai është zoti {...}, i cili është emëruar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë në këtë detyrë dhe vijon të jetë ende.

Sa i përket Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar parashikohet në kreun III të projektvendimit. Edhe në këtë rast janë të njëjtat përcaktime sikundër edhe për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, por me specifikat përkatëse. Konkretisht, selia e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është përcaktuar të jetë në Tiranë, në ndërtesën aktuale të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, sikundër e përcakton edhe ligji.

Ndërsa numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është përcaktuar të jetë 11 (njëmbëdhjetë), nën kufirin minimal që

përcakton ligji dhe mbi të njëjtën logjikë Këshilli do duhet të rivlerësojë këtë numër në vijimësi, referuar objektivave ligjore të saj.

Është përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu se zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, znj. {...}, që ushtron kompetencat e kryetarit të kësaj gjykate në mungesë të tij, qëndron në këtë detyrë dhe ushtron kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit ose të mandatit të zëvendëskryetarit të gjykatës.

E njëjta gjë është përcaktuar edhe sa i përket kancelares në detyrë të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, znj. {...}, e cila edhe ajo do të vijojë të qëndrojë në detyrën e Kancelares së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor ose si rezultat i procesit të verifikimit të plotësimin të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Së fundi, në kreun IV të projektvendimit janë parashikuar fillimi i efekteve të vendimit, pikërisht më datë 19 dhjetor të vitit 2019.

Së fundi është parashikuar edhe momenti i hyrjes në fuqi të vendimit, menjëherë, dhe publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky është në mënyrë të përmbledhur relacioni për projektvendimin “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, nëse kemi ndonjë koment, diskutim apo propozim konkret lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni përkatës, jeni të ftuar.

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë shpreh dakordësinë time lidhur me përmbajtjen e projektvendimit, me përjashtim të pikës 3 të kreut III të këtij vendimi, ku bën fjalë për zëvendëskryetaren e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda sot.

Referuar dispozitave ligjore, në fakt, ligji 98 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, konkretisht në nenin 162, pika 6 parashikon që vetëm kryetari në detyrë i Gjykatës së Krimeve të Rënda qëndron në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Gjykatës së Posaçme.

Zonja {...} që është sot zëvendëskryetare e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, në vlerësimin tim nuk është kryetarja në detyrë. Është zëvendëskryetarja që ushtron kompetencat e kryetarit. Zëvendëskryetari si funksion në gjykatë zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të asaj gjykate dhe për këtë i referohem dispozitave të nenit 26 të ligjit 98/2016 por edhe rregullores që kemi miratuar ne për mënyrën e zgjedhjes së kryetarit. Në vlerësimin tim, sot përbërja pas fillimit të funksionimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, përbërja e gjyqtarëve nuk është e njëjtë me përbërjen e gjykatës së gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda. Ata me fillimin e funksionimit të gjykatës nuk janë më gjyqtarë të krimeve të rënda të apelit, por janë gjyqtarë të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në këtë kontekst vlerësoj që nuk mund të ketë vazhdueshmëri të mandatit të zgjedhur të zëvendëskryetares së zgjedhur si zëvendëskryetare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda edhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit sepse zgjedhja e zëvendëskryetarit është kompetencë e mbledhjes së gjyqtarëve, nuk është as kompetencë e Këshillit. Këshilli normon situatat kur ligji nuk parashikon të gjitha situatat e ndryshme faktike në gjykata dhe ne e kemi bërë këtë gjë në rregulloren tonë për zëvendëskryetarët.

Prandaj vlerësoj që zëvendëskryetari i ri i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Krimet e Rënda duhet të zgjidhet, në zbatim të nenit 26, nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të kësaj gjykate. Në këtë konkluzion arrij duke interpretuar edhe dispozitat tranzitore të ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” që ka të bëjë konkretisht me nenin 86/2, ku parashikohet se: “Këshillat e gjykatave për gjykimin e veprave penale të korrupsionin dhe krimin të organizuar krijohen brenda dy javëve pas krijimit të

gjykatave...” dhe vazhdon dispozita. Nëse ligji do të kishte për qëllim që automatikisht si kryetari dhe kancelari do të kalonin në të njëjtat funksione në Gjykatën e Posaçme edhe zëvendëskryetari, atëherë nuk do të kishte kuptim që të krijohej këshilli i ri. Në vlerësimin tim, vetëm kryetari në detyrë dhe kancelari automatikisht vazhdojnë të njëjtët persona dhe të ushtrojnë të njëjtat funksione. Ndërsa për sa i përket zëvendëskryetarit, ai duhet të përzgjidhet përsëri, me qëllim që të kemi edhe një krijim të një këshilli të ri. Nuk do të kishte sens ky parashikim në qoftë se qëllimi i ligjvënësit ka qenë që si kryetari dhe zëvendëskryetari edhe kancelari automatikisht do të vazhdojnë të quhen të tillë edhe në Gjykatën e Posaçme. Prandaj vlerësoj që pika 4 e projektvendimit të relatuar nga zoti Toska duhet të ndryshohet, pika 3, më fal, e kreut III të projektvendimit të relatuar, duhet të ndryshohet me një formulim të tillë duke parashikuar që: “Menjëherë me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të thirrur nga gjyqtarët me përvojën profesionale më të gjatë, duhet të zgjedhë zëvendëskryetarin e kësaj gjykate”.

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Atëherë, kemi...?

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, Komisioni ka bërë propozimin që zëvendëskryetarja e apelit për krimet e rënda, znj. {...}, që ushtron në fakt kompetencat e kryetarit, në mungesë të tij, është në përputhje me atë që ligji kërkon, ndërsa bën fjalë për kryetarë në detyrë. Ligji nuk bën fjalë për kryetarët e emëruar por për kryetarë në detyrë. Që do të thotë që, kushdo që është duke ushtruar detyrën e kryetarit në gjykatat respektive të shkallës së parë apo apelit të krimeve të rënda, do të vijojë ta ushtrojë këtë detyrë. Qëllimi i ligjit është i qartë. Që ditën e parë që do të fillojë funksionimi i Gjykatave të Posaçme, ato të kenë organet drejtuese të tyre, pra procesi të vijojë normalisht. Nëse do duhet të kishte përcaktuar shprehimisht që edhe zëvendëskryetari do duhet të zgjidhet rishtazi, ligji mund ta kishte bërë një përcaktim të tillë. Sa kohë ligji ka parashikuar që gjithçka transferohet, përfshi edhe personelin administrativ, mundet ta konsiderojmë ometim faktin që nuk ka thënë edhe “zëvendëskryetari konsiderohet”. Por nuk mund të pranojmë interpretimin e

kundërt. Fakti që nuk ka thënë që “zëvendëskryetari vijon të jetë në detyrën e zëvendëskryetarit”, nënkupton që do duhet të zgjidhet një zëvendëskryetar i ri.

Nga zonja Lubonja u tha që është kufizuar numri i gjyqtarëve të gjykatës së apelit dhe për këtë shkak do duhet të ribëhet zgjedhja e zëvendëskryetarit të ri. Kjo nuk është një rrethanë e rëndësishme për ligjin. Në asnjë rast ligji nuk konsideron që në një gjykatë nëse ulet numri i gjyqtarëve apo edhe rritet, zëvendëskryetari zgjidhet rishtazi. Mandati i zëvendëskryetarit është i përcaktuar nga ligji, 3 vjet. Ai duhet të rrijë në detyrë nga momenti që zgjidhet nga ajo mbledhje e përgjithshme e atyre gjyqtarëve që kanë qenë në atë moment në detyrë, derisa të mbarojë mandati. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Desha të shtoj edhe diçka.

Nuk ishte shkak që ishte ulur numri dhe duhet të zgjidhej zëvendëskryetari. Ideja ishte që zëvendëskryetari zgjidhet nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të asaj gjykate. Sot nuk kemi një zëvendëskryetar që e ka zgjedhur mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme. Mbledhja e përgjithshme e kësaj gjykate duhet të zgjedhë zëvendëskryetarin. Kjo dhe në aspektin e përgjithshëm të mënyrës së administrimit se si administrohet gjykata. Gjykata ka një pavarësi administrimi dhe gjyqtarët, ndërhyrjen e tyre në këtë administrim e kanë pikërisht nëpërmjet zëvendëskryetarit që zgjedhin. Ndërkohë që kancelarin e emëron Këshilli dhe kryetarin e emëron Këshilli. Për të ruajtur edhe parimin e mënyrës së administrimit të gjykatës duhet t’u jepet mundësi pikërisht këtyre gjyqtarëve që të shprehin vullnetin sepse sot, unë nuk e di nëse ata gjyqtarë kanë shprehur vullnetin që zonja {...} të jetë edhe zëvendëskryetarja e Gjykatës së Posaçme. Vullneti i tyre ka qenë vetëm që ajo do jetë zëvendëskryetarja e Gjykatës së Krimeve të Rënda. Kemi krijimin e një gjykate të re, pavarësisht se atë e bën ligji dhe ne thjesht deklarojmë fillimin e funksionimit të saj.

Naureda Llagami: Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Për t’i rënë shkurt, edhe unë kam të njëjtin mendim me zonjën Ukperaj dhe mendoj që jo vetëm që s’është ometim por përkundrazi shprehja e qartë e ligjit që është kryetari ai që kalon nga Gjykata e Krimeve të Rënda tek gjykata e re, kalon ai automatikisht në detyrë, derisa zgjidhet kryetari i ri dhe ka një organ emërtese të

ndryshme nga zëvendëskryetari, qoftë edhe për pozicionin që ka secili prej tyre dhe besoj që është e qartë për të gjithë që janë pozicione të ndryshme dhe unë nuk jam fare dakord që zëvendëskryetari është kryetari në detyrë. Koncepti i ligjit për zëvendëskryetarin është që ai e zëvendëson kryetarin një herë në atë kohë kur mund të mungojë dhe jo kur situata e sotme është diçka e jashtëzakonshme, që nuk e kemi vetëm tek kjo gjykatë por e kemi në pjesën më të madhe të gjykatave. Kështu që, nisur nga koncepti dhe pozicioni i zëvendëskryetarit, edhe unë mendoj që gjykata e re që krijohet me emërtesën e re duhet të zgjedhë zëvendëskryetarin e vet dhe nuk ka asnjë pengesë as ligjore, as praktike, dhe nuk cenohet asnjë e drejtë, qoftë edhe në statusin e zonjës/e gjyqtares që është në këtë detyrë, që për mua ishte në këtë detyrë. Sepse nëse ka vullnet nga kolegët që ta rizgjedhin, ta rizgjedhin dhe është një proces që edhe nga ana praktike nuk ka as edhe një problem. Ata mund të mblidhen që nesër dhe brenda gjysmë ore e zgjedhin. Por duke vendosur këtë rregullim siç propozon edhe zonja Ukperaj, ne nuk cenojmë asnjë të drejtë, përkundrazi japim mundësi edhe gjyqtarëve të tjerë që të shprehin dëshirën e tyre për të qenë në atë detyrë dhe të votohen/të fitojë ai që merr votëbesimin e kolegëve.

Naureda Llagami: Atëherë!

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, marrë shkas nga fjala e zonjës Kadi. Sot, aktualisht zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda nuk ushtron funksionin e kryetarit për disa ditë, por në mënyrë permanente, për arsyen e thjeshtë se kryetari i emëruar i kësaj gjykate është i pezulluar ex lege për shkak se është shkarkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Dhe pikërisht, për këtë shkak, ai sot nuk do duhet të jetë as në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kjo është edhe arsyeja që Komisioni, për të vijuar funksionimin institucioni, konsideroi edhe vijimin të ushtrimit të kësaj detyre nga zëvendëskryetari që ka ushtruar praktikisht prej disa muajsh dhe vijon ta ushtrojë këtë detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Faleminderit!

Naureda Llagami: Nëse nuk kemi diskutime të tjera, atëherë procedojmë me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, votimin e propozimit të bërë nga zonja Ukperaj dhe më pas me propozimin e Komisionit?

Atëherë, hedhim në votim ndryshimin e bërë nga zonja Ukperaj lidhur me pikën 3 të kreut III, sipas formulimit të cituar prej saj. Kalojmë në votim? Jeni dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Illir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

(6 pro, 5 kundër.)

Atëherë, kalojmë projekt-aktin në tërësi sipas votimit.

Pranohet propozimi i bërë nga zonja Ukperaj.

Kalojmë sipas rendit të ditës.

Megjithatë, për efekt, a ta lexojmë edhe një herë që ta kemi për efekt të procesverbalit.

Po e lexoj të gjithë projekt-aktin.

Atëherë, “Këshilli vendosi: 1. Fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

II. Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

1. Selia e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në Tiranë, në ndërtesën aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 16 (gjashtëmbëdhjetë).

3. Kryetari në detyrë i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, z. {...}, qëndron në detyrën e Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të magjistratit ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

4. Kancelari në detyrë i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, z. {...}, qëndron në detyrën e Kancelarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor ose si rezultat i procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

III. Për Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

1. Selia e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është në Tiranë, në ndërtesën aktuale të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

2. Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 11 (njëmbëdhjetë).

3. Menjëherë, me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve, e thirrur nga gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë, duhet të zgjedhë zëvendëskryetarin e kësaj gjykate.

4. Kancelarja në detyrë e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, znj.{...}, qëndron në detyrën e Kancelares së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar deri në emërimin e kancelarit të ri të kësaj gjykate, me përjashtim të rasteve kur ka shkaqe për mbarimin e statusit të nëpunësit civil gjyqësor ose si rezultat i procesit të verifikimit të plotësisimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

IV. Fillimi i efekteve të vendimit

1. Ky vendim i fillon efektet më datë 19.12.2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 18.12.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve për caktimin e përhershëm të pesë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:55 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve për caktimin e përhershëm të pesë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për caktimin e përhershëm të pesë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, për gjyqtaren {...}, gjyqtaren {...}, gjyqtaren {...}, gjyqtar {...}, gjyqtar {...}.

Atëherë, projektvendimi do të relatohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, projektvendimi i parë për këtë pikë të rendit të ditës është “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj.{...}”. Është përgatitur edhe një relacion në lidhje me këtë projektvendim. Ky projektvendim, sikundër...

(Anëtarët i rikthehen edhe një herë pikës së parë për të votuar projektvendimin në tërësi, pasi nuk e votuan gjatë trajtimit të pikës.)

Naureda Llagami: Atëherë, përpara se të kalojmë në relatimin e projekt-aktit, hedhim edhe një herë në votim projekt-aktin mbi të cilin u pranua propozimi i zonjës Ukperaj, ta hedhim në tërësi në votim së bashku me propozimin e pranuar/votuar nga shumica e anëtarëve të Këshillit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

(Anëtarët i rikthehen pikës aktuale.)

Dakord. Kalojmë tani tek çështja tjetër e rendit të ditës.

Po, zoti Toska, vazhdo!

Ilir Toska: Atëherë, vazhdojmë me projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”. Ky projektvendim, sikundër edhe relacioni që është përgatitur në këtë rast është mbështetur në rregullimet e parashikuara në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 162, pika 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nuk po citoj përmbajtjen e këtyre dispozitave ligjore, por po shkoj direkt në parashtrimin e fakteve që kanë rëndësi

për ligjin dhe që janë konsideruar në projektvendimin e paraqitur përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Konkretisht, referuar regjistrimit të gjyqtarëve, rezulton se znj. {...} është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Znj. {...}, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 2742, datë 15.09.2000, është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me Dekretin Presidentit të Republikës nr. 3111, datë 02.10.2001, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 4793, datë 28.02.2006, znj. {...} është emëruar në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Referuar faktin se me vendimin e mëparshëm, pra të datës 18.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019, ai ka detyrimin ligjor për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rrethanat kur plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pasi: ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", ndërsa është konfirmuar në detyrë me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.135, datë 05.04.2019, vendim i cili ka marrë formë të prerë pa u ankimuar; po ashtu zonja {...} përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47, pika 2, shkronja "b", të këtij ligji, ndërsa ka ushtruar funksionin e gjyqtarit jo më pak se dhjetë vjet, konkretisht për 19 vjet, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale; po ashtu ajo ka dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të saj bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin përkatës “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares znj. {...}”, vendim ky që do duhet të fillojë efektet në datë 19 dhjetor të vitit 2019, që është edhe dita e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Kalojmë në miratimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Hedhim në votim.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në relatimin e projekt-aktit të dytë që ka të bëjë me caktimin në mënyrë të përhershme për zonjën {...}.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe në këtë rast, referencat ligjore janë të njëjta. Kanë ndryshim referencat faktike sa i përket zonjës {...}.

Ajo figuron në regjistrin e gjyqtarëve si gjyqtare në detyrë ën Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Znj. {...}, me vendimin nr. 15, datë 30.05.1997, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.4143, datë 20.02.2004, znj.{...} është emëruar në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda.

Më tej me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8657, datë 30.07.2014, znj.{...} është emëruar në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda.

Referuar sa më lart, ndërsa fillon funksionimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19 dhjetor 2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin ligjor për caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, znj.{...} pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rrethanat kur ajo plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 2, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht: ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me Vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.43, datë 18.07.2018, ndërsa ky vendim është lënë në fuqi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit; po ashtu zonja {...} përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas nenit 47, pika 2, shkronja “b”, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve”, ndërsa ka ushtruar funksionin e gjyqtarit jo më pak se dhjetë vjet, konkretisht 21 vjet, nga të cilat të paktën 5 vjet si gjyqtar për çështjet penale; po kështu,

zonja {...} dhe familjarët e afërm kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Mbi këtë bazë Komisioni ka paraqitur projektvendimin "Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares znj.{...}". Ndërsa efektet e vendimit fillojnë pikërisht ditën e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pra më datë 19 dhjetor të vitit 2019. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, në qoftë se s'keni ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

(Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohet.)

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda znj.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme për zonjën {...}. Prapë fjalën e ka zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”, e cila është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe përmbush kushtet dhe kriteret e kërkuara nga neni 162, pika 2 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe është konfirmuar në detyrë me vendimin nr.167, datë 21.06.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim ky që ka marrë formë të prerë.

Ajo përmbush kriteret për ngritje në detyrë, ndërsa ka 23 vjet përvojë profesionale, nga të cilat, më shumë se 5 vjet si gjyqtare për çështjet penale. Po kështu, ajo dhe familjarët e saj dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Edhe në këtë rast është parashikuar në projektvendim që efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim, sipas propozimit të bërë nga Komisioni? Projekt-akti.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarës në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme për zotin {...}. Fjalën e ka sërish zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarit z. {...}”. Edhe zoti Lara është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Ai përmbush kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji neni 162, pika 2 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për t’u caktua në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndërsa ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe është konfirmuar në detyrë me vendimin e Komisionit të

Pavarur të Kualifikimit nr. 151, datë 29.05.2019, vendim ky që ka marrë formë të prerë pa u ankimuar. Po ashtu zoti Lara përmbush kriteret për ngritjen në detyrë sipas nenit 47, pika 2, shkronja “b” e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa ka 23 vjet përvojë profesionale, nga të cilat të paktën 5 vjet si gjyqtar për çështjet penale. Po kështu ai dhe familjarët e tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Në projektvendim është parashikuar që efektet e tij të fillojnë më datë 19 dhjetor 2019, ditë kur fillon funksionimin dhe Gjykata e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin, sipas propozimit të bërë nga zoti Toska dhe Komisioni përkatës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda z.{...} pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përhershme për z.{...}. Sërish fjalën zoti Ilir Toska, kryetar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, edhe për zotin {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar projektvendimin “Për caktimin e tij në pozicion, në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, ndërsa zoti {...} është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda dhe plotëson kushtet dhe kriteret e kërkuara nga neni 162, pika 2 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 149, datë 20.05.2019, vendim ky që ka marrë formë të prerë pa ankimuar. Po kështu zoti {...} përmbush kriteret për ngritje në detyrë sipas përcaktimeve të nenit 47, pika 2, shkronja “b” e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa ka përvojë profesionale prej 20 vjetësh, nga të cilat të paktën 5 vjet si gjyqtar për çështjet penale. Po ashtu zoti {...} dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake sipas ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Në projektvendim është parashikuar edhe momenti i fillimit të efekteve të vendimit, pikërisht në datë 19 dhjetor të vitit 2019, kur fillon funksionimin dhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përhershme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda z.{...} pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 18.12.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve për caktimin e përkohshëm të trembëdhjetë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:55 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin {...}, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve për caktimin e përkohshëm të trembëdhjetë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për caktimin e përkohshëm të trembëdhjetë gjyqtarëve pranë gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar.

Atëherë, fillojmë konkretisht me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshëm për gjyqtarin {...}. Sërish fjalën...

Zonjën {...}.

Fjalën ia jap prapë zotit Ilir Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”. Ky projektvendim, sikundër referohet edhe në relacion, është mbështetur në nenin në nenin 135, pika 4, nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 162, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nuk po citoj dispozitat e përmendura më lart. Po them faktet që kanë të bëjnë me zonjën {...}. Ajo, referuar regjistrin të gjyqtarëve, rezultoi të jetë gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda edhe në këto kushte, ndërsa në datë 19 dhjetor të vitit 2019 Këshilli vendosi fillimin e funksionimit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, atëherë ai do duhet, ka detyrimin ligjor të caktojë në pozicion, në mënyrë të përkohshme, gjyqtaren në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, znj. {...} pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rrethanat nuk plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga ligji, pikërisht neni 162, pika 3, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht: ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit, sipas përcaktimeve të ligjit "Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë të saj; po ashtu, zonja {...} dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar që efektet e tij të fillojnë pikërisht më datë 19 dhjetor të vitit 2019, vit kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicionin në mënyrë të përkohshme për zonjën {...}. Sërish fjalën e ka relatori, zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur projektvendim “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares znj. {...}”. Në kushtet kur ajo, referuar regjistrin të gjyqtarëve është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga neni 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi: ndaj saj ka

filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, ajo dhe familjarët e saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Edhe në këtë rast është përcaktuar që efektet e vendimit të fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim projekt-aktin e propozuar nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme të gjyqtarës znj. {...}. Sërish fjalën e ka zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur edhe projektvendimin “Për caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtarës znj. {...}”. Zonja {...} është aktualisht gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Po ashtu, ajo plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga neni 162, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për t’u caktuar në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në rrethanat kur ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, zonja {...} dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

Edhe në këtë rast, sipas projektvendimit, efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicionin në mënyrë të përkohshëm për zonjën {...}, projekt-akt i cili do të relatohet sërish nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Projektvendimi tjetër i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsiston në caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të gjyqtares znj. {...}. Edhe zonja {...} plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga ligji për t’u caktuar në këtë pozicion, ndërsa është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; ndërkohë që ajo dhe familjarët e afërm të saj

kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është përcaktuar se efektet e vendimit fillojnë më datë 19 dhjetor 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, për zonjën {...}. Relatimi i projekt-aktit sërish do bëhet nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë edhe për gjyqtaren znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për caktimin e saj në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, ndërsa ajo plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga ligji për t’u caktuar në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Konkretisht ajo është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, ajo dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, sipas projektvendimit efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoto Toska!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit të propozuar nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarës në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarës znj. {...}, relativiteti i të cilit do bëhet sërish nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe për gjyqtarën znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur projektvendim “Për caktimin e saj në pozicion në mënyrë të përkohshme në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, ndërsa plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 3 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht ajo është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; ajo dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është përcaktuar që efektet e vendimit fillojnë më datë 19 dhjetor të

vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

E hedhim projekt-aktin, sipas propozimit të bërë nga Komisioni, në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshëm të gjyqtares znj. {...}, relatimi i të cilit do bëhet sërish nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe për gjyqtaren znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendim “Për caktimin në pozicion të saj në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, ndërsa ajo plotëson kushtet dhe kërkesat e kërkuara nga neni 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht ajo është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, ajo dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është parashikuar që efektet e tij fillojnë më datë 19.12.2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshëm të gjyqtares znj. {...}. Edhe për këtë fjalën e ka zoti Ilir Toska për relatimin.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, edhe për gjyqtaren znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendim “Për caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në kushtet kur zonja {...} plotëson kërkesat dhe kushtet e kërkuara nga neni 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ndërsa ajo është gjyqtare në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; ndaj saj ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, ajo dhe familjarët e afërm të saj kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është parashikuar që efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas Komisionit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda znj. {...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë tek çështja tjetër, projekt-akti tjetër, që ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshëm të z. {...}. Fjalën sërish e ka zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës edhe për gjyqtarin z. {...} ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në

rrethanat kur ai plotëson kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në nenin 162, pika 2 (*lapsus, pasi është pika 3*) e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ndërsa është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; ndaj tij ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, ai dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është parashikuar që efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë projekt-aktin për votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda z.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshëm të gjyqtarit z. {...}. Sërish fjalën e ka zoti Toska.

Ilir Toska: Atëherë edhe për gjyqtarin {...} është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës projektvendim “Për caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” në rrethanat kur ai plotëson kushtet dhe kërkesat e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ndërsa është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; ndaj tij ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, zoti {...} dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është përcaktuar që efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Hedhim në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda z.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme të z. {...}. Fjalën e ka sërish zoti Toska.

Ilir Toska: Atëherë edhe për gjyqtarin z. {...} Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e tij në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në rrethanat kur zoti {...} plotëson kushtet dhe kërkesat e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ndërsa zoti {...} është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; ndaj tij ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, ai dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të

telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, është përcaktuar në projektvendim që efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda z.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të zotit {...}. Fjalën e ka sërish zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë edhe për gjyqtarin z. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për caktimin e tij në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në rrethanat kur zoti {...} plotëson kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në nenin 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ndërsa është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; ndaj tij ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; dhe po ashtu, ai dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është përcaktuar se efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda z.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, zotit {...}. Sërisht fjalën e ka zoti Ilir Toska për relatimin!

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe për gjyqtarin z. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur projektvendimin “Për caktimin në pozicion në mënyrë të përkohshme, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në rrethanat kur zoti {...} plotëson kushtet dhe kërkesat e kërkuara nga ligji, neni 162, pika 3 e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ndërsa ai është gjyqtar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda; ndaj tij ka filluar procesi i rivlerësimit kalimtar por ende nuk ka një vendim të formës së prerë për konfirmimin në detyrë; po ashtu, zoti {...} dhe familjarët e afërm të tij kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar". Edhe në këtë rast, në projektvendim është përcaktuar që efektet e tij fillojnë më datë 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillon funksionimin edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë në votim të projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Caktimin në pozicion, në mënyrë të përkohshme, të gjyqtarit në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda z.{...}, pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 19.12.2019.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 18.12.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve për transferimin e shtatë gjyqtarëve pranë disa gjykatave (përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:55 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj* | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Shënim: Zoti Hallunaj nuk merr pjesë në shqyrtimin e projekt-aktit të transferimit të tij.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënive me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 5. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
- 6. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 7. Erion Fejzulla, USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve për transferimin e shtatë gjyqtarëve pranë disa gjykatave (përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës).

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për transferimin e shtatë gjyqtarëve pranë disa gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm.

Fillojmë me projekt-aktin e parë, i cili ka të bëjë me transferimin e gjyqtarës znj. {...}. Relatimi i projekt-aktit do të bëhet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë për gjyqtaren znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendim për transferimin e saj. Në këtë rast, ky projektvendim, siç referohet edhe në relacionin e përpiluar për këtë rast bazohet në nenin 147, pika 1, nenin 147/a, shkronja “a” dhe nenin 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe nenin 162, pikat, 1, 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nuk po ndalem në citimin e

këtyre dispozitave, por po referoj faktet që kanë rëndësi për ligjin në lidhje me gjyqtaren znj. {...}.

Konkretisht, referuar regjistrin të gjyqtarëve, zonja {...} është gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, emëruar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.4139, datë 20.02.2004.

Ndërsa me vendimin e sotëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019, ai ka obligimin që të caktojë/transferojë zonjën {...}, në kushtet kur ajo nuk mund të qëndrojë pas kësaj date në pozicionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, sikurse përcakton pika 1 e nenit 162 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çka obligon Këshillin të vendosë për transferimin e saj në një pozicion tjetër.

Pozicioni ku një gjyqtar i gjykatave për krimet e rënda mund të caktohet është ai në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, referuar për këtë pikave 2 dhe 3, të nenin 162, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Por, në rastin e znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund ta caktojë atë në një pozicion të tillë, qoftë në mënyrë të përhershme, ashtu dhe të përkohshme, për sa kohë me vendimin nr.197, datë 27.09.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndaj znj. {...} është vendosur masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra”, në bazë të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendim ky që pavarësisht se është ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pengon jo vetëm caktimin e përhershëm të znj. {...} në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, por edhe caktimin e përkohshëm të saj në këtë pozicion.

Për rrjedhojë, Këshilli i Lartë Gjyqësor obligohet të caktojë gjyqtaren znj. {...} në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel gjykate, por me juridiksion të përgjithshëm, për sa kohë ajo, pavarësisht masës disiplinore të dhënë me një vendim që ende nuk është përfundimtar dhe pezullimit ex lege nga detyra e saj në pritje të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sikurse përcakton neni 62, pika 1, i ligjit nr.84/2016 “Për

rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ajo vijon të ruajë statusin e magjistratit dhe të gëzojë të drejtën e pagës në masën 75% të saj, sikurse përcakton kjo dispozitë e ligjit, por edhe neni F, pika 5, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në kushtet kur gjyqtarja znj. {...} është në pritje të vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka të drejtë të shqyrtojë dhe të gjykojë çështje, por gëzon vetëm të drejtën e pagës, duke konsideruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërsa ka detyrimin për të caktuar në një pozicion pune gjyqtaren në fjalë, do të duhet të konsiderojë po ashtu edhe funksionalitetin e gjykatave me juridiksion të përgjithshëm ku gjyqtarja duhet të caktohet, në kuptimin që caktimi i saj në pozicion të mos pengojë plotësimin e vakancave emergjente në këto gjykata.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar edhe projektvendimin “Për transferimin e gjyqtares znj.{...}”, ku në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar që gjyqtarja znj.{...} transferohet në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar nga data 19 dhjetor të vitit 2019, pra data e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Një transferim i tillë i gjyqtares znj. {...} garanton të drejtën aktuale që ajo gëzon nga pasja e statusit të magjistratit, pra të drejtën e pagës.

Nga ana tjetër, për garantimin e të drejtave që znj. {...} i rrjedhin nga statusi i magjistratit, të cilat bëhen efektive vetëm në rast të konfirmimit të saj në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar se ajo, në një rast të tillë, gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, në gjykatat e apelit me juridiksionin të përgjithshëm, sikurse një gjë të tillë magjistratit ia garanton neni 44, pika 2, shkronja “b”, e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke patur në konsideratë se transferimi i znj. {...} është pa pëlqim në kushtet kur për shkak të ligjit gjykata ku ajo ka patur emërimin, pra Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, nuk do të ekzistojë më si e tillë duke filluar nga data 19.12.2019.

Më tej në projektvendim parashikohet detyrimi i Këshillit për njoftimin e vendimit gjyqtarës {...}, po ashtu edhe Gjykatës së Apelit Durrës.

Në pikën 4 të projektvendimit parashikohet e drejta e ankimit dhe afatit për paraqitjen e ankimit kundër këtij vendimi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-propozimit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit z. {...}.

Okej! E kalojmë në fund.

Kalojmë në transferimin e gjyqtarit z. {...}. Projekt-aktin do ta relatojë zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe në rastin e gjyqtarit z.{...}, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës është përgatitur projektvendimi për transferimin e tij në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm. Edhe në këtë rast, sikundër edhe në rastin e zonjës {...}, Këshilli ka detyrimin që të transferojë zotin {...}, për sa kohë ai, pavarësisht se është në detyrë në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është shkarkuar nga detyra dhe është i pezulluar për shkak të ligjit. Ndërkohë që më datë 19 dhjetor të vitit 2019 do të fillojë funksionimin Gjykata e Posaçme e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, që nënkupton ndërkohë pushimin e funksionimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Komisioni, sipas projektvendimit, i propozon Këshillit që zoti {...} të transferohet në Gjykatën e Apelit Vlorë, duke filluar nga data 19 dhjetor të vitit 2019, pra data e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe në këtë rast, sikundër në rastin e zonjës {...}, apo edhe rastet që do vijnë më pas, në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjyqtari zoti {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për t’u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Janë përcaktuar në pikat e tjera të projektvendimit detyrimi për njoftimin e vendimit gjyqtarit z.{...} si dhe e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi diskutim?

Po, zoti Bici!

Medi Bici: Kisha unë një diskutim, meqenëse zoti {...} ka një status tjetër, ka qenë kryetar i Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda për shumë kohë dhe meqenëse në Gjykatën e Apelit Tiranë ka vende të lira, do kisha mendimin që transferimi i tij të bëhesh në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Naureda Llagami: Atëherë, pra zoti Bici kërkon ndryshimin e vendimit, transferimin e zotit {...} jo në Gjykatën e Apelit Vlorë por në Gjykatën e Apelit Tiranë. Atëherë, hedhim në votim propozimin e bërë nga zoti Bici.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Illir Toska: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Kundër.

Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga Komisioni.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin lidhur me transferimin e gjyqtarit z.{...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit, zotit {...}. Fjalën e ka sërish zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe për gjyqtarin zotin {...}, i cili aktualisht është në detyrë i emëruar pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, por i pezulluar për shkak të ligjit, ndërsa Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur propozimin për transferimin e tij në një gjykatë të apelit me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht pranë Gjykatës së Apelit Korçë, duke filluar nga data 19 dhjetor të vitit 2019, ditë kur fillojnë funksionimin Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe pushon praktikisht së funksionuari Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, ku zoti {...} ka emërimin, transferim ky që do të vijojë deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe në këtë rast, pas konfirmimit në detyrë të zotit {...} nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, është përcaktuar në projektvendim se gëzon të drejtën të zgjedhë për t’u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Më tej, në projektvendim, pika 3 dhe 4, është parashikuar detyrimi për njoftimin e vendimit gjyqtarit {...}, po kështu edhe e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim. Nëse nuk keni ndonjë diskutim, kalojmë në votim të projekt-aktit të propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, që bëhet fjalë për transferimin e gjyqtarit, zotit {...}. Lidhur me këtë projekt-akt kalojmë në relatimin nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Edhe për gjyqtarin zotin {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin për transferimin e tij në një gjykatë apeli me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht në Gjykatën e Apelit Vlorë. Në kushtet kur zoti {...} është në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, por është shkarkuar me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërsa ndaj këtij vendimi është paraqitur ankim, por për shkak të ligjit ai vijon të jetë i pezulluar nga detyra.

Në rrethanat si më lart, ndërsa me datë 19 dhjetor të vitit 2019 fillojnë funksionimin Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, pozicioni ku zoti {...} ka emërimin në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda nuk do të ekzistojë më, për sa kohë pushon së funksionuari si e tillë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda. Për rrjedhojë Këshilli do duhet ta transferojë atë në një pozicion tjetër me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht është propozuar Gjykata e Apelit Vlorë.

Edhe në këtë rast, transferimi i gjyqtarit {...} do të vijojë deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ndërkohë që në pikën 2 të projektvendimit është përcaktuar që në rast konfirmimi në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, gjyqtari {...} gëzon të drejtën të zgjedhë për

t'u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Edhe në këtë rast, në pikat 3 dhe 4 e projektvendimit është parashikuar detyrimi për njoftimin e vendimit gjyqtarit si dhe e drejta e tij për të ankimuar këtë vendim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro. (pa mikrofon)

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit sipas tekstit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit z. {...}, fjalën për të cilin e ka zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Atëherë, edhe për gjyqtarin zotin {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin për transferimin e tij në një gjykatë apeli me juridiksion të përgjithshëm, konkretisht në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar nga data 19 dhjetor të vitit 2019, datë kur fillojnë funksionimin Gjykatat e Posaçme të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe datë deri në cilën vazhdon të ekzistojë dhe të funksionojë Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ku zoti {...} ka emërimin e tij. Ky

transferim bëhet i detyrueshëm në rrethanat kur për zotin {...} ka një vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin e tij nga detyra, ku pavarësisht faktit që ky vendim është apeluar, zoti {...} nuk mund të caktohet në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe për rrjedhojë Këshilli ka detyrimin që ta trasferojë atë në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel, por me juridiksion të përgjithshëm. Është propozuar Gjykata e Apelit Durrës.

Transferimi do të vazhdojë deri në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj zotit {...} përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Po kështu edhe në këtë projektvendim është përcaktuar që në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm të Apelimit, gjyqtari {...}, gëzon të drejtën të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë ën atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Në pikat 3 dhe 4 të projektvendimit është parashikuar detyrimi i Këshillit për t'i njoftuar vendimin zotit {...} si dhe e drejta e tij për ta ankimuar këtë vendim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë për votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin për transferimin e gjyqtarit z. {...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër, i cili ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit z. {...}, fjalën për të cilën e ka sërish, relatimi i të cilit do bëhet nga zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe për gjyqtarin z. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur projektvendim për transferimin e tij, tashmë ndryshe nga gjyqtarët që u referuan pak më herët, në një gjykatë të nivelit të parë me juridiksion të përgjithshëm, për sa kohë zoti {...} është gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, por ndaj tij, me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur shkarkimi nga detyra dhe ai për momentin është i pezulluar për shkak të ligjit, çka obligon Këshillin që në pamundësi për ta caktuar atë qoftë në mënyrë të përhershme apo të përkohshme në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ta transferojë në një gjykatë të njëjtë nivel, por me juridiksion të përgjithshëm. Në rastin konkret, për zotin {...} është propozuar që të transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke filluar nga data 19 dhjetor i vitit 2019 kur fillon fillojnë funksionimin Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe pushon së funksionuari Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ku zoti {...} ka emërimin.

Ky transferim do të vijojë deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe në këtë rast, në rast të konfirmimit në detyrë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, gjyqtari z. {...} gëzon të drejtën për t’u transferuar në çdo pozicion që do të jetë i lirë në atë moment apo që pritet të bëhet i lirë brenda 6 muajve në gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Edhe në këtë rast, në projektvendim, në pikat 3 dhe 4 është përcaktuar detyrimi i Këshillit për njoftimin e vendimit si dhe e drejta e gjyqtarit për ta ankimuar atë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit për transferimin e gjyqtarit z. {...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Atëherë, kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit të fundit.

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Atëherë, për procedurë.

Meqenëse konform nenit... pika e fundit ka të bëjë me transferimin tim, konform nenit 72 të ligjit 115/2016 “Mbi organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” kam detyrimin që të deklaroj natyrën e interesit dhe pengesës për të marrë pjesë në këtë diskutim dhe në këtë moment unë largohem, që të jem sa më transparent.

(Del nga salla e mbledhjes zoti Dritan Hallunaj dhe nuk merr pjesë në trajtimin e kësaj çështjeje.)

Naureda Llagami: Atëherë, në kushtet që zoti Hallunaj ndodhet në situatën që parashikon neni 72, atëherë vazhdon shqyrtimi i projekt-aktit pa prezencën e zotit Hallunaj. Ia kaloj fjalën zotit Ilir Toska lidhur me projekt-aktin për transferimin e gjyqtarit z. Dritan Hallunaj.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur edhe një projektvendim për transferimin e gjyqtarit z. Dritan Hallunaj, që është edhe gjyqtari i fundit që aktualisht ka emërimin në gjykatat për krimet e rënda, ndërsa Këshilli ka obligimin tashmë me fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të caktojë në mënyrë të përhershme, përkohshme apo të transferojë gjyqtarët e gjykatave për krimet e rënda.

Në këtë rast, ky projektvendim mbështetet në nenin 147, pika 1, 147 shkronja “a” dhe 179, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 44, pika 1, shkronja “b” dhe pika 2, shkronja “b”, si dhe nenin 162, pikat 1, 3 dhe 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Përmbajtjen e këtyre dispozitave nuk po e citoj.

Atëherë, po evidentoj faktet konkrete që kanë rëndësi për ligjin në lidhje me projektvendimin e paraqitur në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.

Referuar regjistrin të gjyqtarëve, rezulton se z.Dritan Hallunaj është gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, emëruar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.4042 datë 23.12.2003.

Me vendimin e datës 18 dhjetor, pra me vendimin e datës së sotme, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19 dhjetor të vitit 2019. Në këto kushte, ndërsa në datë 19 dhjetor të vitit 2019 do fillojë funksionimi edhe i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, zoti Dritan Hallunaj nuk mund të jetë pas kësaj date në pozicionin e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, sikurse e përcakton pika 1 e nenit 162, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, çka obligon Këshillin e Lartë Gjyqësor të vendosë për transferimin e tij në një pozicion tjetër.

Pozicioni ku një gjyqtar i gjykatave për krimet e rënda mund të caktohet është ai në Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, referuar për këtë pikave 2 dhe 3, të nenin 162, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Por, në rastin e z.Dritan Hallunaj, pavarësisht se ai me vendim

përfundimtar ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (konkretisht me vendimin nr.56, datë 01.08.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë, i cili ka marrë formë të prerë), si dhe pavarësisht se përmbush kriteret për ngritjen në detyrë, sipas përcaktimeve të nenit 47 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (ka 21 vite përvojë profesionale, prej datës 29.07.1998), Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk mund ta caktojë atë në një pozicion të tillë, për sa kohë ai dhe familjarët e afërm të tij nuk kanë dhënë pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, sikurse kërkohet nga neni 162, pika 2, e ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për rrjedhojë, Këshilli i Lartë Gjyqësor obligohet të caktojë gjyqtarin z.Dritan Hallunaj në një pozicion tjetër të të njëjtit nivel gjykate, por me juridiksion të përgjithshëm, për sa kohë ai, pavarësisht se prej datës 12.12.2018 nuk ushtron detyrën e gjyqtarit, pasi është zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ai vijon të ruajë statusin e magjistratit dhe për këtë shkak duhet të jetë i caktuar në një pozicion në sistemin gjyqësor.

Mbi këtë bazë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për transferimin e gjyqtarit z.Dritan Hallunaj”, ku në pikën 1 të projektvendimit, është parashikuar që gjyqtari z.Dritan Hallunaj transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke filluar nga data 19.12.2019, pra nga data e fillimit të funksionimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Në lidhje me gjykatën ku z.Dritan Hallunaj propozohet të transferohet sipas pikës 1 të projektvendimit, është patur në konsideratë se transferimi i tij është pa pëlqim në kushtet kur për shkak të ligjit gjykata ku ai ka patur emërimin, pra Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, nuk do të ekzistojë më si e tillë duke filluar nga data 19.12.2019.

Nisur nga një rrethanë e tillë, duke konsideruar zbatimin në këtë rast, por edhe në të gjitha rastet e ngjashme, të nenit 44, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, që garanton të drejtën e magjistratit që të zgjedhë për t'u transferuar në çdo pozicion, që është i lirë apo që pritet të bëhet i lirë brenda gjashtë muajve, për z.Dritan Hallunaj u garantua kjo e drejtë, ndërsa ai, përmes një deklaratë me shkrim, zgjodhi të transferohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Përveç sa më lart, në lidhje me gjykatën ku z. Hallunaj propozohet të transferohet sipas pikës 1 të projektvendimit, u mbajt në konsideratë se ai është zgjedhur anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të Tiranës, në respektim të nenit 7, pika 1, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Nisur nga kjo, për të ruajtur formatimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për të garantuar në këtë mënyrë përfaqësimin në Këshill të gjyqtarëve sikundër ligji kërkon, zgjedhja e z.Dritan Hallunaj sa i përket transferimit të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është në përshtatje dhe kënaq edhe këtë aspekt ligjor.

Në pikën 2 të projektvendimit është parashikuar detyrimi i Këshillit për njoftimin e vendimit gjyqtarit, ndërsa në pikën 3 të projektvendimit parashikohet e drejta dhe afati i ankimit ndaj vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin e propozuar nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Nëse jo, atëherë kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga ky Komision.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi transferimin e gjyqtarit z.Dritan Hallunaj, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim tjetër, atëherë mbledhjen për sot e konsideroj të mbyllur. Shihemi nesër.

Faleminderit për prezencën!

Gjithë të mirat!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor